



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 52/2020 regjistër (JR)  
Datë 23.11.2020

Nr. 17 i vendimit  
Datë 20.04.2023

VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Sokol Çomo</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 20.04.2023, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 52/2020 (JR), datë 23.11.2020, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Rozeta Qirjaqi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 272, datë 08.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut neni 6; Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F i Aneksit të Kushtetutës; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 62, 63 dhe vijues; ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, neni 46.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, e cila, pasi kërkoi kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes dhe marrjen e provave të reja bashkëlidhur ankimit dhe

parashtrimeve, përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 272, datë 08.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë. Për këtë arsye, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni.
2. Bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 e 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim "ILDKPKI"), nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim "DSIK") dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim "KLP").

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, referuar deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit *vetting*, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar, duke konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka pasaktësi në deklaratimet e interesave private ndër vite; (ii) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të pasurive; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; dhe (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2. DSIK-ja, pas procedurës së kontrollit të kriterit të figurës së subjektit të rivlerësimit, konstatoi *përshtatshmërinë* e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës. KLP-ja i dërgoi Komisionit raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar, pasi kreu procedurën përkatëse të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin objekt shqyrtimi, pasi kreu procesin e rivlerësimit për të tria kriteret, Komisioni vendosi të shkarkojë nga detyra subjektin e rivlerësimit, bazuar në kriteret e vlerësimit të pasurisë dhe atë të kontrollit të figurës, duke konkluduar se:
  - a) *ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1991 – 2016;*
  - b) *ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për të ardhurat;*
  - c) *ka bërë deklarim të pasaktë lidhur me pasuritë e krijuara dhe burimin e ligjshëm;*
  - ç) *ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;*
  - d) *nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të saj dhe të personave të lidhur në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës; si dhe*
  - d) *nuk ka deklaruar në deklaratën për kontrollin e figurës procedimin dhe dënimin e nipit të saj, sipas nenit 283/2 të Kodit Penal.*

3.1. Vlerësimi për kriterin e pasurisë bazohet në konkluzionin e analizës së dy pasurive, e konkretisht:

3.1.1. Për truallin me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, në Korçë, me vlerë prej 300.000 lekësh, të blerë në vitin 1996, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit *nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të krijimit dhe ka pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vlerën prej (-) 181.290 lekësh.*

3.1.2. Për shtëpinë e banimit me sipërfaqe 141 m<sup>2</sup>, në Korçë, me vlerë prej 7.000.000 lekësh, të ndërtuar në truallin më sipër në vitet 2004 - 2006, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është përpjekur *të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në deklaratën e pasurisë, sikurse edhe në deklaratat periodike/vjetore për vitet respektivë. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me këtë pasuri, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion bazohet në vlerësimin se:*

- a) Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë sipërfaqen e kësaj pasurie, e cila rezulton me sipërfaqe 282 m<sup>2</sup>, përfshirë edhe njësi/dyqan. Në deklaratën e pasurisë në rivlerësim, subjekti ka deklaruar shtëpi banimi me sipërfaqe 141 m<sup>2</sup>. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht e, për pasojë, ky fakt ka pasqjellë marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
- b) Subjekti ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vlerën prej (-) 8.692.060 lekësh, referuar vlerës së kostove të ndërtimit, sipas çmimeve mesatare të aplikuara nga Enti Kombëtar i Banesave për vitet 2004 - 2006.

3.1.3. Përfundimet e mësipërme u bazuan në vlerësimin e kryer nga Komisioni për të ardhurat e deklaruara nga subjekti, nga disa burime. Konkretisht:

(i) Për të ardhurat e deklaruara nga punësimi i personit të lidhur/bashkëshortit në Greqi, prej 12.000.000 GRD (dhrakmi greke) për periudhën 1991 - 1999, Komisioni konkludoi se nuk u provua punësimi dhe ligjshmëria e tyre, *sipas parashikimeve të nenit D, të pikës 3 të Aneksit të Kushtetutës.*

(ii) Për shumën prej 1.000.000 lekësh, të depozituar në bono thesari në Bankën e Shqipërisë në vitin 2008, deklaruar nga subjekti të marrë prej bashkëshortit nga i ati, Komisioni ka vlerësuar ta konsiderojë të pabesueshme prejardhjen e shumës, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar për këtë qëllim në *deklaratën periodike/vjetore* për vitin 2008 dhe konstatoi që *babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka qenë në pamundësi financiare [(-) 864.073 lekë], për krijimin e saj në vitin 2008.* Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për vitin përkatës.

(iii) Për dhurimin e deklaruar të shumës prej 400.000 lekësh, në vitin 2005, nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, Komisioni konstatoi pamundësi financiare *të dhuruesit.* Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për vitin përkatës.

(iv) Të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit në periudhën mars 1995 - tetor 1998, gjatë së cilës subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka jetuar me ta dhe kanë mbuluar shpenzimet e jetesës, përkatësisht, kanë qenë të pamjaftueshme. Sipas analizës së kryer në Komision,

prindërit e subjektit kanë pasur pamundësi financiare në vlerën (-) 491.235 lekë, për mbulimin e shpenzimeve të jetesës së subjektit bashkë me fëmijët e saj, për këtë periudhë. Komisioni konkludoi se për këto të ardhura është bërë deklaram i pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për përballimin e shpenzimeve të jetesës.

(v) Për shtimin e llogarive bankare në ish-Bankën Amerikane, në vlerën prej 5.000 USD, në vitin 2006 dhe më pas në vitin 2008 me një vlerë tjetër prej 4.000 USD, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit *është në pamundësi financiare*, për kryerjen e shpenzimeve të jetesës në vlerën prej (-) 153.152 lekësh.

3.1.4. Bazuar në analizën financiare, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për vitet 1994 - 2016, në vlerën totale prej (-) 9.218.491 lekësh.

3.2. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, me fokus procedimin penal të z. J. G. (nipit të subjektit të rivlerësimit), për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, nën dritën e nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Procedimi penal në fjalë bën pjesë në rrethin e veprave të cilat sipas përkufizimit të pikës 15, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 e vendosin këtë person në kushtet e personit të përfshirë në krimin e organizuar. Ky person ka qenë i proceduar penalisht dhe me masë “arrest në burg” si person i dyshuar për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve” të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, në kohën e plotësimit të formularit për kontrollin e figurës nga subjekti i rivlerësimit. Për këto arsye, Komisioni ka zbatuar prezumimin në favor të masës disiplinore të shkarkimit të subjektit, e cila nuk ka mundur të provojë të kundërtën, sipas nenit DH të Aneksit të Kushtetutës.

### III. Shkaqet e ankimit

4. Në datën 20.08.2020, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim kundër vendimit objekt shqyrtimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), për aspekte procedurale dhe për themelin, siç parashtrihen më poshtë. Këto kërtime janë përsëritur edhe në parashtrimet e saj përpara seancës, në datën 10.04.2023. Konkretisht, subjekti ka kërkuar në Kolegji:
  - *kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative, me vendim nr. 272, datë 08.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;*
  - *marrjen e provave të reja [bashkëlidhur ankimit], si dhe çdo provë që do të jetë e nevojshme apo do të kërkohet në proces;*
  - *ndryshimin e vendimit nr. 272, datë 08.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të saj.*

#### A. Parashtrimet në ankim

5. Lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se:
  - 5.1. Hetimi i çështjes, dyshimet dhe kalimi i barrës së provës nga Komisioni u kryen në kushte të pabarabarta me subjektet e tjera të rivlerësimit.
  - 5.2. Komisioni i ka lënë afatin gjashtë (6) ditor për t’u njohur me materialet e çështjes dhe për të paraqitur shpjegime dhe prova për një periudhë para tre dekadash, veçanërisht për fakte që

lidhen me të ardhurat e bashkëshortit nga puna në emigracion në Greqi. Seanca dëgjimore u caktua dhe shqyrtimi i çështjes u zhvillua pa i dhënë kohën e nevojshme për të paraqitur prova të reja, lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga punësimi në Greqi, për të cilat kishte aplikuar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore në Greqi dhe duke mos marrë në konsideratë kufizimet e kalimit të kufirit, për shkak të pandemisë Covid-19.

5.3. Komisioni duhet të aplikonte standardin *kushtetues* të dyfishit të pasurisë, pretendon subjekti, si një lloj njohje që ligji i bën informalitetit që ka ekzistuar pas viteve 90-të në Shqipëri, përfshirë edhe remitancat.

5.4. Së bashku me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe disa komunikime me postë elektronike me Komisionin, të administruara në dosjen e Komisionit, përkatësisht: (a) *e-mail*-et e datave 11.06.2020 dhe 16.06.2020, lidhur me njoftimin e rezultateve të hetimit nga Komisioni; (b) *e-mail*-in e datës 22.06.2020, lidhur me dërgimin e raportit shpjegues dhe provave nga subjekti i rivlerësimit pas rezultateve të hetimit; dhe (c) *e-mail*-in e datës 06.07.2020, lidhur me dërgimin e dokumentacionit shtesë nga subjekti i rivlerësimit.

6. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se:

6.1. Nuk kishte qëllim për të dokumentuar të dhëna të rreme ose të pasakta për sipërfaqen e shtëpisë së banimit në Korçë të ndërtuar në vitet 2004 - 2006, për sa kohë që në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting* ka dorëzuar si prova praktikën e lejes së ndërtimit dhe certifikatën e pronësisë.

6.2. Kostoja e ndërtimit të shtëpisë së banimit në Korçë nuk ka qenë sa kostoja mesatare, sipas Entit Kombëtar të Banesave (në vijim "EKB"), por në total në vlerën prej 7.000.000 lekësh, nga të cilat 4.600.000 lekë kostoja bazë e ndërtimit, ndërsa pjesa tjetër janë punimet shtesë të kryera nga bashkëshorti dhe vëllai i saj, si dhe shpenzimet e arredimit.

6.3. Burimet e krijimit përbëhen nga të ardhurat nga puna në emigracion e bashkëshortit për periudhën 1991-1999, në vlerën 12.000.000 GRD, të depozituara në ish-Bankën e Kursimeve Korçë, nga pagat e subjektit të rivlerësimit të depozituara në ish-Bankën e Kursimeve Korçë, si dhe nga interesat bankare ndër vite.

6.4. Në analizën financiare të kryer në Komision, nuk janë përfshirë gjendjet e depozitave në vitin 2003 në vlerën 7.773.863,11 lekë dhe se Komisioni ka dubluar kostot për punime shtesë në vlerën 1.200.000 lekë, duke i shtuar në të njëjtën vlerë edhe kostot e arredimit.

6.5. Komisioni nuk ka bërë një hetim të thelluar, analizë provash dhe faktesh për rezultatin e mungesës së burimeve financiare të ligjshme dhe nuk ka shpjeguar metodologjinë e përdorur për llogaritjet e shpenzimeve për vitet 1994 - 1996.

6.6. Për periudhën maj 1994 - mars 1995, nuk ka pasur shpenzime jetese, pasi kjo periudhë përkon me lejen e lindjes së vajzës kur ka jetuar në Greqi dhe shpenzimet i paguante bashkëshorti, ndërsa, për periudhën mars 1995 - tetor 1998, nuk ka pasur shpenzime, pasi ka jetuar me prindërit dhe shpenzimet e jetesës janë mbuluar prej tyre.

6.7. Për dhurimin prej 400.000 lekësh nga vëllai I. G. në vitin 2005, subjekti pretendoi se ka gjeneruar të ardhura të kënaqshme nga puna ndër vite në emigracion në Greqi dhe, për rrjedhojë, ka pasur mundësi për të kryer dhurimin.

6.8. Për sa i përket shumës prej 1.000.000 lekësh, të investuar nga bashkëshorti A. Q. në bono thesari në vitin 2008, subjekti e pretendoi të marrë nga babai i bashkëshortit S. Q., i cili e justifikonte me burime të ligjshme.

6.9. Së bashku me ankimin, në mbështetje të këtyre argumenteve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe disa akte shkresore: (i) kthim përgjigje, datë 04.08.2020, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Selanik, Greqi, Sektori i Ndërtimit, për të siguruarin A. Q. në kategorinë Sigurime Shoqërore të Rënda Ndërtimi<sup>1</sup>, për vitet 1995, 1996 dhe 1998; (ii) kthim përgjigje, datë 23.07.2019, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Kostur (Greqi), Sektori i Ndërtimit; (iii) shkresën, datë 26.06.2019, për të siguruarin I. G. në kategorinë Sigurime Shoqërore të Rënda Ndërtimi, për vitet 1998, 1999, 2000, 2001 dhe 2002; (iv) librezat/vërtetimet e sigurimeve shoqërore; si dhe (v) certifikatën e vdekjes së vëllait [I. G.], datë 02.03.2020, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Korçë.

7. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit ka parashtuar se:

7.1. Rrethana e kryerjes së veprës penale nga nipi J. G. është në formën e mbajtjes nga një i mitur, përdorues i një sasive minimale bimësh narkotike, e cila nuk mundëson vënien e pasurisë në rrugë kriminale dhe, rrjedhimisht, jashtë qëllimit të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 10192/2009”).

7.2. Fakti që nuk jeton në të njëjtën banesë me nipin, si dhe mungesa e marrëdhënieve familjare dhe kontakteve me të, që prej vitit 2015, për shkak të mosmarrëveshjeve me kunatën, *konfirmon* mungesën e kontakteve e, për pasojë, mungesën e dijenisë nga ana e saj, për veprimet e tij.

7.3. E vetme, lidhja gjinore nuk e përcakton automatikisht si një kontakt të papërshtatshëm dhe deklarimi ose jo në formular i kësaj rrethane nuk do të sillte asnjë pasojë në prezumimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

#### *B. Parashtrimet e datës 10.04.2023*

8. Duke konfirmuar sa ka argumentuar në ankim, në këto parashtrime, subjekti i rivlerësimit u fokusua në pretendimet e ngritura dhe përmbledhura më sipër. Së bashku me parashtrimet, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe disa dokumente, të cilat ka kërkuar të merren në cilësinë e provës, përkatësisht: (i) aktin e ekspertimit kontabël që mban datën 31.03.2023, me fokus të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1994 - 2016; (ii) aktin e vlerësimit të kulturave bujqësore, datë 12.05.2022, të përpiluar si shkresë e thjeshtë nga një agronom e që ka për qëllim vlerësimin e të ardhurave të babait të subjektit të rivlerësimit nga toka bujqësore në vitet 1992 - 1999, sikurse edhe të ardhurave nga toka bujqësore e vjehrrit të subjektit të rivlerësimit në vitet 1992 - 2007; dhe (iii) fotografi të babait të subjektit të rivlerësimit, duke tregtuar produkte

<sup>1</sup> Në përgjigje të kërkesës nr. {\*\*\*} prot., datë 20.07.2020, lidhur me sigurimet shoqërore për vitin 2001.

bujqësore në tregun e qytetit të Korçës, që sipas subjektit të rivlerësimit i përket periudhës 1992 - 1999.

9. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit ka ritheksuar pretendimin për mosdijeni të procedimit penal të nipit për shkak të një mosmarrëveshje familjare e më pas shkëputjes së marrëdhënieve të subjektit të rivlerësimit me familjen e vëllait. Subjekti i rivlerësimit argumenton se procedimi/dënimi i nipit ka qenë ngjarje episodike. Nuk ka pasur asnjë të dhënë se ai është i përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka pasur asnjë arsye që ta fshihte këtë fakt. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se, nëse formulari i kontrollit të figurës do të ishte i pasaktë, kjo do të ishte konstatuar nga DSIK-ja, e cila e ka pajisur me certifikatë sigurie të kategorisë C, “Tepër Sekret”.

9.1. Së bashku me parashtrimet, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe disa dokumente, të cilat ka kërkuar të merren në cilësinë e provës, konkretisht: (i) dy deklarata të datës 24.03.2023, përkatësisht nga daja<sup>2</sup> dhe tezja<sup>3</sup> e subjektit të rivlerësimit, të cilët konfirmojnë ndërprerjen e komunikimit mes subjektit të rivlerësimit dhe familjes së të vëllait, duke nisur nga viti 2015 dhe deri në vitin 2018, për shkak të mosmarrëveshjeve familjare; dhe (ii) certifikatën e sigurimit të personelit për subjektin e rivlerësimit, të kategorisë C, “Tepër Sekret” e që mban datën 09.01.2018.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, për rivlerësimin e subjekteve, parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.
11. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit<sup>4</sup>, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.
12. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit, kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues vendos se plotësohen kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e

<sup>2</sup> Deklarata nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.03.2023, e z. I. H..

<sup>3</sup> Deklarata nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.03.2023, e z. D. B..

<sup>4</sup> Vendimi i arsyetuar i Komisionit iu njoftua subjektit të rivlerësimit në datën 06.08.2020. Ndaj vendimit të arsyetuar është ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit, protokolluar me nr. {\*\*\*} prot., datë 20.08.2020 dhe pranuar nga Komisioni me vendimin nr. 272/1, datë 31.08.2020.

cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 272, datë 08.07.2020, të Komisionit, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, më datë 20.04.2023.

*B. Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me procesin e rregullt ligjor*

13. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka cenuar parimet procedurale, pasi hetoi çështjen, hodhi dyshimet dhe i kaloi asaj barrën e provës, në kushte të pabarabarta me subjektet e tjera të rivlerësimit. Trupi gjykues sjell në vëmendje se kompetencat e Komisionit në kryerjen e procesit të rivlerësimit janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016. Në këto kushte, në procesin e kryer nga Komisioni në funksion të hetimit administrativ, që përfshin edhe kalimin e barrës, sikurse edhe hapat e tjerë deri në vendimmarrje, Komisioni ka ushtruar kompetencat e dhëna në ligj. Mënyra e funksionimit të Komisionit ka kaluar testin e vlerësimit të kryer nga Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet vendimit nr. 2/2017, sikurse edhe atë të kryer nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”). Kjo e fundit, në çështjen *Xhoxhaj*, pasi ka analizuar pretendime të njëjta në drejtim të parimit të gjykatës së paanshme<sup>5</sup>, nuk ka gjetur shkelje të nenit 6, pika 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNj”). Për këto arsye, trupi gjykues e gjen të panevojshme të ndalet më tej në argumente në funksion të nenit 6 të KEDNj-së, të cilët tashmë janë analizuar e shtuar në një çështje kyç të jurisprudencës së GjEDNj-së.

13.1. Trupi gjykues konstaton se edhe pretendimi se hetimi dhe kalimi i barrës së provës u krye në kushte të pabarabarta me subjektet e tjera të rivlerësimit është i pabazuar. Nga aktet në fashikull nuk rezulton asnjë veprim që do të mund të argumentohet edhe *teorikisht* si pabarazi në mënyrën sesi Komisioni ka kryer hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit. Përpos pyetjeve të individualizuara për shpjegimet dhe deklaratimet e vetë subjektit, Komisioni rezulton të ketë kryer të njëjtat veprime që kryen për subjektet e rivlerësimit, të cilët në mënyrë specifike ose në mënyrë të përgjithshme parashikohen në “Hapat Procedurale të Unifikuar”<sup>6</sup>: ka dërguar pyetësorë, ka verifikuar denoncimet e publikut, ka kaluar barrën e provës për përfundimet paraprake, si dhe përfundimisht ka zhvilluar seancën dëgjimore dhe vendosur masën disiplinore të shkarkimit, bazuar në individualitetin e fakteve dhe rrethanave të kësaj çështjeje, siç do të shtjellohen edhe në vijim. Në këto kushte, pretendimi për pabarazi kundrejt subjektit në veprimet e Komisionit paraqitet i pakuptimtë dhe i pabazuar.

14. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni i ka lënë afat të shkurtër 6 (gjashtë) ditore për t’u njohur me materialet e çështjes dhe për të paraqitur shpjegime dhe prova për një periudhë para tre dekadash, në kushtet kur bashkëshorti i saj nuk mund të udhëtonte për në Greqi.

14.1. Trupi gjykues vëren se edhe ky pretendim është i pabazuar. Komisioni e ka njoftuar subjektin e rivlerësimit në datën 11.06.2020, lidhur me përfundimin e hetimit, duke i caktuar afat prej 11 ditësh për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur prova. Pavarësisht se rezultatet e hetimit, në formë elektronike, i janë dërguar në datën 16.06.2020, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë njohur me dosjen deri në datën 22.06.2020 dhe të ketë paraqitur parashtrime dhe prova në afatin e caktuar nga Komisioni.

<sup>5</sup> Ndër të tjerë, në paragrafët 230, 307, 308 dhe 317.

<sup>6</sup> Miratuar me vendimin nr. 7, datë 12.02.2018, të Komisionit, i ndryshuar. Shih <https://kpk.al/wp-content/uploads/2019/12/Hapat-Procedurale-te-Unifikuar-2-1.pdf>.



**14.2.** Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka qenë në gjendje të komunikonte me Komisionin për të konfirmuar dërgimin e rezultateve të hetimit, ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumente, të cilat Komisioni i ka pranuar, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjektit të rivlerësimit i janë respektuar garancitë procedurale në zbatim të nenit 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 47 të Kodit të Procedurave Administrative. Subjektit i është garantuar e drejta për të paraqitur shpjegime për faktet, rrethanat dhe çështjet ligjore, si dhe të depozitojë prova e propozojë veprime për zgjidhjen e çështjes. Po ashtu, nuk rezulton që subjekti të ketë kërkuar kohë shtesë. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi për kohë të shkurtër nuk rezulton i argumentuar dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk është cenuar në të drejtën e tij për të dhënë mendime, shpjegime dhe për të paraqitur prova.

**14.3.** Përpos këtyre rrethanave konkrete të procesit të zhvilluar për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit thekson se subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni që deklarimet e saj do të duhet të shoqëroheshin me dokumentacion provues që në momentin kur hyri në fuqi ligji nr. 84/2016, përpara se ajo të plotësonte deklaratën e pasurisë për rivlerësimin. Kuadri ligjor që normon rivlerësimin ka parashikuar *shprehimisht* që barra e provës në procesin e rivlerësimit i përket subjektit të rivlerësimit, që nënkupton përgjegjësinë për të provuar me dokumentacion sa deklarohet në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Ky detyrim del qartë në pikën 5, të neni Ç të Aneksit të Kushtetutës, në pikën 1, të nenit 32 dhe pikat 2 dhe 3, të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, sikurse edhe Udhëzimi nr. 4095/2016, i Inspektorit të ILDKPKI-së për zbatim të këtyre dy akteve, të cilët përcaktojnë shprehimisht nevojën për të mbështetur çfarë deklarohet me dokumentacion.

**14.4.** Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit që synon të reduktojë gjithë harkun kohor nga ndryshimet kushtetuese e ligjore për rivlerësimin deri në vitin 2020 [thujse katër (4) vjet], gjatë të cilit ajo ishte në dijeni për domosdoshmërinë e mbledhjes së dokumentacionin mbështetës, në harkun kohor që përkon me vetëm një ndër segmentet përfundimtare të hetimit administrativ dhe argumentuar për të njëjtin qëllim edhe ndalimet për shkak të pandemisë së Covid-19, rezulton i pabazuar edhe duke abstraguuar nga sa është konstatuar nga aktet në fashikull. Për shkak të ligjit, subjekti ka qenë në dijeni të nevojës për të mbështetur pretendimet e saj me dokumentacion thujse katër (4) vite përpara se rezultatet e hetimit administrativ konstatuan mungesën e tij [dokumentacionit provues]. Pikërisht, nën dritën e këtij detyrimi ligjor, subjekti ka autorizuar një avokat për të mbledhur dokumentacionin që në vitin 2019. Për të gjitha këto arsye, pretendimi i subjektit është i pabazuar dhe kontradiktor me veprimet e kryera prej saj.

**14.5.** Së bashku me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe përgjigjen e datës 04.08.2020, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Selanik, Greqi, Sektori i Ndërtimit, për personin e lidhur e që mbulon harku kohor 1995 - 1996 dhe vitin 1998. Përgjigja rezulton të jetë për kërkesën e subjektit që mban datën 20.07.2020, e thënë ndryshe pas shpalljes së vendimit të Komisionit, që mban datën 08.07.2020. Siç referohet edhe më sipër, në datën 17.10.2019, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit kishte autorizuar një avokat që ushtronte profesionin në Greqi, për të kryer veprimet që lidhen me mbledhjen e dokumentacionit. Kërkesa për dokumentacion institucioneve në Greqi është paraqitur, jo vetëm pas seancës dëgjimore të datës 30.06.2020, por edhe pas shpalljes së vendimit në datën 08.07.2020. Gjithë sa më sipër, provojnë që subjekti i rivlerësimit, pikërisht për shkak të qenies në dijeni të nevojës për të mbështetur pretendimet me dokumentacion, ka ndërmarrë hapa në këtë drejtim në vitin

2019. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit i gjen të pambështetura pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me cenimin e procesit, për shkak të afatit të shkurtër dhe pamundësisë për të kërkuar dokumentet lidhur me të ardhurat e bashkëshortit në Greqi.

14.6. Për sa më sipër, në analizë harmonike të pretendimeve dhe të akteve të sjella nga subjekti në ankim, si dhe në parashtrimet e datës 10.04.2023 [përmbledhur në paragrafët 6.9, 8 dhe 9.1], nën dritën e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, që përcakton refuzimin e pranimit të provave kur ndalohet nga ligji, trupi gjykues i vlerësoi të panevojshme për zgjidhjen e çështjes provat shkresore në fjalë. Trupi gjykues konstaton që këto akte të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për procesin e rregullt ligjor së bashku me ankimin, jo vetëm që nuk plotësojnë kërkesën e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, që normon provat e reja në ankim – nuk rezulton se provat nuk janë paraqitur gjatë procesit në Komision pa faj të subjektit – por edhe paraqiten të parëndësishme për vendimmarrjen. Trupi gjykues vendosi refuzimin e marrjes së tyre si prova të reja në gjykimin në Kolegj.

### *C. Analiza e shkaqeve të ankimit për vlerësimin e kriterit të pasurisë*

#### *C/I. Pasuria shtëpi banimi në Korçë*

15. Një ndër pasuritë, për të cilat Komisioni ka konstatuar problematika e subjekti ka ngritur shkaqe ankimi, është shtëpia e banimit në Korçë, me sipërfaqe 141 m<sup>2</sup>. Kjo shtëpi deklarohet e ndërtuar në vitet 2004 – 2006, në truallin me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, të blerë në vitin 1996. Vlera e ndërtimit bazë është deklaruar nga subjekti në 4.600.000 lekë, me vlerë totale ndërtimi prej 7.000.000 lekësh. Burim krijimi, sipas deklaratës së pasurisë, janë specifikuar: të ardhurat nga puna e bashkëshortit në emigracion, pagat e depozituara në ish-Bankën e Kursimeve Korçë, si dhe nga interesat bankare ndër vite. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në deklaratën *vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore dhe ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e saj në vlerën prej (-) 8.692.060 lekësh.

15.1. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se mungon dashja për të dokumentuar të dhëna të rreme ose të pasakta për sipërfaqen e ndërtesës, për sa kohë që në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting* ka dorëzuar praktikën e lejes së ndërtimit dhe certifikatën e pronësisë. Për sa i përket konkluzionit për mungesë burimesh, subjekti pretendon se kostoja e ndërtimit të shtëpisë nuk duhet të përllogaritet bazuar në standardet e kostos mesatare, sipas EKB-së. Nga totali në vlerën prej 7.000.000 lekësh, nga të cilat 4.600.000 lekë ishin kostoja bazë e ndërtimit, pjesa tjetër janë punimet shtesë të kryera nga bashkëshorti dhe vëllai i saj, si dhe shpenzimet e arredimit.

15.2. Nga aktet në fashikull, përfshirë ato që janë depozituar së bashku me deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se këto pretendime të subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara. Nga këto dokumente, konkretisht certifikata për vërtetim pronësie e vitit 2006 dhe aktet lidhur me lejimin e zhvillimit të truallit dhe ndërtimin e tij në vitin 2004, lëshuar respektivisht nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë (në vijim “ZVRPP Korçë”) dhe nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Korçë (në vijim “KRRT”), rezulton se sipërfaqja e certifikuar e ndërtesës nga ZVRPP-ja Korçë ishte 141 m<sup>2</sup>. Sikurse rezulton nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 13.04.2004, i KRRT-së, numri i kateve

do të ishte dy (2) dhe vetëm njëri kat do të mund të ishte 141 m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja totale e ndërtesës e ndarë në dy kate do të ishte 282 m<sup>2</sup>.

15.3. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë vetëm gjysmën e sipërfaqes së ndërtesës e konkretisht 141 m<sup>2</sup> përkundër 282 m<sup>2</sup>, që rezulton të jetë realisht sipërfaqja e dy kateve. Kjo mënyrë veprimi nuk përputhet me detyrimin për të përshkruar pasurinë, sipas përcaktimeve të shtojcës 2 të deklaratës së pasurisë, bashkëlidhur ligjit nr. 84/2016. Në këtë rubrikë të ligjit, në faqen 5, deklaruesve u kërkohet shprehimisht të përshkruajnë *hollësisht sipërfaqen* dhe të dhëna të tjera që specifikojnë vlerën e paguar, si dhe burimet, pavarësisht nëse janë të regjistruar ose jo në regjistrat publikë. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë të sipërfaqes së ndërtimit, në kundërshtim me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

15.4. Subjekti i rivlerësimit pretendoi, po ashtu se vlera e ndërtimit të shtëpisë nuk përkon me koston mesatare të përcaktuar nga EKB-ja. Në total, ajo pretendon se ka paguar vlerën prej 7.000.000 lekësh, nga të cilat 4.600.000 lekë është kostoja *bazë* e ndërtimit, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga punimet shtesë, si dhe shpenzimet e arredimit. Punimet shtesë, pretendon subjekti, janë kryer nga bashkëshorti dhe vëllai i saj.

15.5. Trupi gjykues vëren se ndryshe nga sa ka pretenduar në ankim, në deklaratat periodike/vjetore 2005 – 2006, të cilat në procesin e rivlerësimit mund të përdoren si provë<sup>7</sup>, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar vlerën e ndërtesës në vlerën 7.000.000 lekë. Autorizimi i Zyrës së Urbanistikës së Bashkisë Korçë, që mban datën 21.06.2004, sipas të cilit 1% e investimit përkon me vlerën prej 46.950 lekësh e, për rrjedhojë, investimi përlllogaritet në parim në 4.600.000 lekë, është i pamjaftueshëm për të përcaktuar saktësisht vlerën përfundimtare. Kjo përlllogaritje e përafërt e momentit të nisjes së ndërtimit [vitit 2004] dhe gjatë fazës së miratimit të lejes së ndërtimit është një indicie e paplotë, e cila nuk mund të përdoret si bazë për vlerën përfundimtare të investimit. Po ashtu, edhe dokumentet e tjera justifikuese, si preventivi i shoqërisë ndërtuese [{"\*\*\*"} ShPK] dhe procesverbali i kolaudimit, datë 20.01.2006, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit nuk përmbajnë të dhëna për shpenzimet që kanë shoqëruar ekzekutimin e punimeve. Për pasojë, këto dokumente nuk mund të vërtetojnë vlerën e ndërtesës. Në të njëjtën linjë arsyetimi, raporti i vlerësimit të pasurisë nga një ekspert privat, që mban datën 09.03.2020, nuk rezulton të bazohet mbi përlllogaritjen e kostos që i atribuohet 1 (një) metri katror sipërfaqeje ndërtimi në drejtim të volumit të punimeve të kryera, referuar gjendjes së objektit.

15.6. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton që përlllogaritja e vlerës së investimit nga Komisioni, bazuar në çmimet e miratuara nga EKB-ja për vitin përkatës, është i drejtë. Në kushtet kur këto standarde shpenzimesh vijnë nga burime të njohura/zyrtare e të besueshme, ato përbëjnë një bazë vendimmarrjeje që plotëson kriteret e përcaktuara nga neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016<sup>8</sup>. Kjo qasje është reflektuar në mënyrë konsekuente në zbërthimin në praktikë të kësaj dispozite edhe nga Kolegji, në çështje të ngjashme, në të gjitha rastet kur subjektet e rivlerësimit nuk

<sup>7</sup>Në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

<sup>8</sup>“[ 4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelitit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes. [...]”.

mund të provojnë me dokumentacion justifikues shpenzimet e kryera, si situacione punimesh, fatura tatimore apo koston e ndërtimit të objekteve<sup>9</sup>. Në këtë linjë, duke mbajtur në konsideratë kostot mesatare të ndërtimit për vitet 2004 - 2006, sipas EKB-së<sup>10</sup>, kostoja e ndërtimit për një kat [me sipërfaqen 141 m<sup>2</sup>] do të ishte 3.495.860 lekë, ndërsa për të dy katet, në vlerën prej 6.991.720 lekësh. Kjo shumë është thujse e njëjtë me atë të pasqyruar nga subjekti në deklaratimet periodike/vjetore, në vlerën 7.000.000 lekë. Për rrjedhojë, ky shkak ankimi i subjektit të rivlerësimit, që ka për qëllim të reduktojë vlerën e shpenzimeve për efekt të procesit të rivlerësimit, është i pabazuar në ligj dhe në deklaratimet e kryera prej saj ndër vite.

15.7. Trupi gjykues vlerëson, po ashtu se, përkundër sa ka pretenduar në ankim, gjatë procesit të hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar punime shtesë prej 1.200.000 lekësh, kryer nga bashkëshorti dhe vëllai. Sipas kronologjisë së specifikuar nga subjekti i rivlerësimit, këto shpenzime janë kryer në harkun kohor mes marrjes së lejes së ndërtimit dhe lejes së shfrytëzimit e që konkretisht nënkupton periudhën 13.04.2004 - 30.03.2006. Nga aktet në fashikull rezulton se kolaudimi i ndërtesës, që nënkupton edhe përfundimin e ndërtimeve, mban datën 20.01.2006. Në kushtet kur kostoja e punimeve të ndërtimit deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike/vjetore për vitin 2005, që përfshin punimet dhe shpenzimet me të cilat ato shoqërohen deri në datën 31.12.2005, është përcaktuar në vlerën 7.000.000 lekë, trupi gjykues dedukton që punimet shtesë të deklaruara nga subjekti në vlerën 1.2 milionë lekë logjikisht do t'i shtoheshin koston së ndërtimit të kësaj ndërtese dhe, për pasojë, janë përtej koston bazë.

15.8. Subjekti i rivlerësimit pretendon se pasuria është krijuar me të ardhurat e bashkëshortit nga puna në emigracion, në vlerën 12.000.000 GRD, të depozituara në ish-Bankën e Kursimeve Korçë, si dhe nga interesat bankare në vite. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave. Për këtë arsye, në analizën financiare të kryer nga Komisioni nuk janë përfshirë të ardhurat e deklaruara nga emigracioni dhe as të ardhurat e interesave të gjeneruara nga depozitat e krijuara me paratë e emigracionit.

15.9. Nga analiza e akteve në fashikull, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumente për të ardhurat e pretenduara nga bashkëshorti në emigracion në vitet 1991 – 1994 gjatë gjithë procesit të hetimit administrativ e të ardhurat e pretenduara nga puna e personit të lidhur/bashkëshortit, në Greqi, mbetën deklarative. Për pasojë, në kushtet kur nuk u provua ekzistenca apo sasia e këtyre të ardhurave, përjashtohet edhe teorikisht përmbushja e kriterit të ligjshmërisë së tyre, sipas përcaktimit kushtetues të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ky vlerësim i trupit gjykues, sikurse referuar edhe më sipër, mban në konsideratë edhe sa është konstatuar në paragrafin 14.5 më sipër, lidhur me aktet e përcjella së bashku me ankimin dhe faktin që subjekti nuk provoi se ishte në pamundësi për sjelljen e tyre më herët – kërkesë e shprehur e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012.

---

<sup>9</sup> *Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit nr. 15/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Reshka (parag. 36); vendimin e Kolegjit nr. 34/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Entela Prifti, (parag. 67); vendimin e Kolegjit nr. 34/2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Isuf Shehu (parag. 53); si dhe vendimin e Kolegjit nr. 35/2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Alkelina Gazidedja (parag. 15.11.3).*

<sup>10</sup> *Sipas parashikimeve të udhëzimeve të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 04.03.2004, nr. 5, datë 23.11.2005 dhe nr. 5, datë 07.09.2006. Sipas këtyre akteve nënligjore, në qytetin e Korçës për këtë periudhë kohore, kostoja rezulton në vlerën 24.793 lekë/m<sup>2</sup>.*

**15.10.** Përpos këtij konstatimi, trupi gjykues thekson se përgjigja e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Selanik, Greqi, për sa i përket të ardhurave për vitet 1995, 1996 dhe 1998, nuk përmban të dhëna për sasinë e të ardhurave të fituara nga bashkëshorti. Vërtetimi referon sigurim shoqëror për 198 ditë punësimi, përgjatë tri viteve në fjalë. Më tej, edhe nëse do të kryhej ushtrimi financiar i kërkuar prej subjektit, për të përdorur për analogji të ardhurat e vëllait të saj në të njëjtin sektor [ndërtimin], si indikator për standardin e pagesës së fituar edhe nga bashkëshorti i saj, duke zbatuar pagesën ditore më të lartë -- 14.400 GDR/ditë -- për periudhën janar 1998<sup>11</sup>, të ardhurat e bashkëshortit *teorikisht* në total mund të arrinin deri në 2.851.200 GDR, barabartë me 8.367 *euro* ose 1.115.674 *lekë*<sup>12</sup>. Përlllogaritja teorike u bë duke u bazuar vetëm në ditët e punës që rezultojnë nga aktet e sigurimeve shoqërore, të cilat deduktohen nga sigurimet e paguara nga personi i lidhur në periudhat kohore përkatëse<sup>13</sup>. Pas kësaj do të rezultonte sërish mungesë burimesh për të krijuar pasuritë dhe përballuar shpenzimet jetike të përlllogaritura, sipas EUROSTAT-it për një person në Greqi dhe, konkretisht, rezulton me balancë negative prej (-) 2.533.35 eurosh në vitin 1995 dhe (-) 24.91 euro në vitin 1996. Viti 1998, i cili ka rezultuar me balancë pozitive në Komision, do të rezultonte me tepriçë të ardhurash prej 674.92 eurosh.

**15.11.** Për të provuar të ardhurat nga puna e personit të lidhur/bashkëshortit [në vlerën 12 milionë GDR, sipas subjektit] e për të lidhur këto të ardhura me depozitat e çelura në Bankën e Kursimit në Shqipëri në shkurt 1998, subjekti referon dy shkresa nga degë të Bankës Kombëtare të Greqisë [NBG], në Greqi<sup>14</sup>. Nëpërmjet tyre konfirmohet çelja e llogarisë *në tetor 1991*, si dhe depozitime e tërheqje në vlerën afro 5 milionë GDR<sup>15</sup> në harkun kohor tetor 1991 - dhjetor 1996, nga bashkëshorti/personi i lidhur. Subjekti pretendon se shuma e tërhequr, që në shkurt 1997, sipas saj, kishte arritur vlerën 8.000.000 GDR, është sjellë dorazi në Shqipëri nga bashkëshorti. Një vit më pas, këto para janë depozituar në Bankën e Kursimeve Korçë, pasi janë konvertuar në lekë. Pjesën tjetër të të ardhurave të fituara, bashkëshorti e ka sjellë dorazi periodikisht dhe e ka depozituar në vitet 2000-2001 në bankë në Shqipëri, pretendon subjekti. Tërheqjet nga këto depozita janë përdorur për ndërtimin e shtëpisë në vitet 2004-2006. Subjekti ka sjellë edhe akte nga banka për të provuar që dokumentacioni i detajuar i transaksioneve është asgjësuar nga banka, për shkak të kohës që ka kaluar.

**15.12.** Trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje disa aspekte përcaktuese në analizën e kryer përkundër pretendimeve të mësipërme, mbi të cilën është konkluduar se subjekti nuk

---

<sup>11</sup> Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të ardhurat e personit tjetër të lidhur/vëllait të subjektit, nga puna në emigracion, për efekt të përlllogaritjes së mundësisë financiare për mbulimin e vlerës 400.000 lekë, deklaruar si dhuratë bërë subjektit. Ky dokumentacion është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas mbylljes së hetimit administrativ në Komision.

<sup>12</sup> Kursi i këmbimit i përdorur, 1 EUR = 340.74 GRD dhe 1 GRD = 0.293 EUR, është llogaritur duke kryqëzuar kursin e këmbimit fixing EUR/LEK dhe GRD/LEK i datës 03.01.2001 i publikuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.

[https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi\\_zyrtar\\_i\\_kembimit/Arkiva\\_e\\_kursit\\_te\\_kembimit/](https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/)

<sup>13</sup> Nëse të ardhurat e punësimit të bashkëshortit në vitet 1995, 1996 dhe 1998 do të përlllogariteshin sipas akteve të sjella në ankim do të përfshohesh shuma prej 591,65 eurosh për vitin 1995, në vitin 1996 prej 3.254 eurosh dhe në vitin 1998 prej 4.521 eurosh.

<sup>14</sup> Lëshuar në datat 08.06.2018 dhe 28.01.2019.

<sup>15</sup> Depozitimet janë ekuivalente të 1.715.850 lekëve [4.385.000 GDR, ose 12.869 euro]. Janë përfituar interesa në vlerën totale prej 220.607 lekësh [563.780 GDR, ose 1.655 euro]. Në periudhën qershor 1994 -- dhjetor 1996, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka tërhequr vlerën 1.936.458 lekë [4.948.780 GDR ose 14.524 euro].

provoi të ardhurat, sikurse as gjurmë të ndjekshme të tyre në krijimin e pasurisë objekt analize/ankimi. Kjo analizë duhet të shihet si vijim dhe arsyetim integral i sa është arsyetuar gjerësisht më sipër për mosprovimin e punësimit, vlerës së fituar prej tij dhe ligjshmërisë së të ardhurave të pretenduara nga puna e personit të lidhur në emigracion si burim krijimi i pasurive objekt analize.

i. Së pari, pretendimi i subjektit për të ardhura që arrijnë në shumën 12 milionë GDR nuk gjen mbështetje në asnjë dokumentacion e, si i tillë, mbeti deklarativ. E vetmja gjurmë dhe e vetmja vlerë që referohet nga banka është ajo rreth 5 milionë GDR [4.948.780,00 drahmi]<sup>16</sup>. Në shkresë, shuma e depozituar përkon me atë të tërhequr më datë 19.12.1996. Edhe interesat bankare të referuara nga një shkresë më e hershme e arkivës së bankës<sup>17</sup>, referojnë një interes me vlerë të ulët [563.780 GDR] krahasuar me atë që pretendon subjekti - tërheqje të vlerës 8.000.000 GDR [referuar më sipër].

ii. Së dyti, trupi gjykues konstaton se janë jo bindëse pretendimet e subjektit që përpiqen të argumentojnë një variant faktesh, sipas të cilit personi i lidhur ka zgjedhur të heqë dorë nga parashikueshmëria dhe siguria që ofronte sistemi bankar i Greqisë në vitin 1996, për të ruajtur jashtë sistemit bankar një sasi të konsiderueshme të ardhurash në *cash*, në lekë, në Shqipëri, në prag të periudhës më dramatike në historinë e tranzicionit shqiptar, kur siguria qytetare dhe sistemi bankar pësuan kolaps<sup>18</sup> dhe, si rrjedhojë, ndodhën ngjarjet e fillim të vitit 1997. Në këto zhvillime, qytetarët shqiptarë humbën kursimet për shkak të piramidave financiare, ndërsa monedha zyrtare pësoi rënie të thellë të vlerës blerëse me inflacion deri në 42%<sup>19</sup>. Nuk rezulton që subjekti të ketë pretenduar depozitim të tyre në firmat piramidale apo tërheqjen e ndonjë shume, e cila do të krijonte mundësinë teorike për të gjurmuar lëvizjet e këtyre fondeve në veprimtari të ndryshme me përfitim financiar të realizuar apo potencial, që do të shpjegonte lëvizjen në fjalë apo transfertën dorazi në Shqipëri.

iii. Së treti, është po ashtu jo bindës pretendimi i subjektit që këto para janë ruajtur në *cash* deri në vitin 1998, të konvertuara në lekë, ndërkohë që, siç referuam më lart, mungon logjika ekonomike e kryerjes së këtyre veprimeve në këtë periudhë kohore. Në të njëjtën linjë logjike, nuk paraqet besueshmëri as pretendimi i subjektit që personi i lidhur ka fituar e transferuar dorazi në Shqipëri edhe të ardhura të tjera, përpos vlerës prej rreth 5 milionë GDR, nëse sillet në vëmendje që tashmë personi i lidhur prej vitesh ishte përfitues dhe mbështetëj në sigurinë që ofronte sistemi bankar në Greqi, që edhe nëse kjo vlerë [rreth 5 milion GDR] do të konsiderohej si e ardhur nga emigracioni dhe do të përfshihej në analizë, subjekti përsëri do të gjendej në kushtet e pamundësisë financiare. Nga ana tjetër, subjekti nuk arriti të qartësojë nevojën emergjente për t'i ruajtur e transferuar këto të ardhura të konsiderueshme dorazi, gjatë vizitave në Shqipëri, në periudhën kohore në fjalë, gjatë së cilës nuk deklaroi të ketë kryer

<sup>16</sup> Sipas shkresës së Bankës Kombëtare të Greqisë, dega e Arnea-s, me NR.PROT. {\*\*\*}.

<sup>17</sup> Shih poshtëshënimin nr. 16 më sipër.

<sup>18</sup> <https://www.imf.org/external/pubs/ft/fandd/2000/03/jarvis.htm>, <https://english.defensie.nl/topics/historical-missions/mission-overview/1997/the-albanian-pyramid-scheme-crisis>.

<https://www.managementstudyguide.com/albanian-revolution-and-pyramid-schemes.htm>;

<https://www.gazetatema.net/2021/11/22/nga-zbulimi-i-sudes-dhe-xhaferrit-ne-93-te-letra-sekrete-e-meksit-per-boden-e-berishen-ne-96-historia-e-26-firmave-piramidale-qe-i-moren-kursimet-shqiptareve>;

[https://www.bankofalbania.org/rc/doc/cani\\_haderi\\_shq\\_204\\_1\\_12933.pdf](https://www.bankofalbania.org/rc/doc/cani_haderi_shq_204_1_12933.pdf);

<https://www.ft.com/content/810367e5-e0b1-4221-b303-f3012a177437>.

<sup>19</sup>[https://www.bankofalbania.org/rc/doc/inflacioni\\_8660.pdf](https://www.bankofalbania.org/rc/doc/inflacioni_8660.pdf), faqe 18 ose

<https://ndiqparate.al/?p=17329&lang=en>.

shpenzime të ngutshme që do ta bënin të nevojshme tërheqjen nga siguria bankare në Greqi në vitin 1996 dhe mbajtjen në *cash* në Shqipëri, në periudhën problematike për sigurinë e rendin që përbënte viti 1997 e viti 1998.

**15.13.** Për të gjitha këto mangësi, në logjikën e fakteve të pretenduara nga subjekti, si dhe përpos analizës së mësipërme për mosprovimin e ligjshmërisë së të ardhurave nga puna e personit të lidhur në Greqi, trupi gjykues konstaton se vlerësimi i Komisionit për të mos përllogaritur këto të ardhura si burim i krijimit të llogarisë bankare nga personi i lidhur në shkurt 1998 është i bazuar. Në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit, Kolegji nuk e pranoi këtë pretendim të subjektit dhe e gjeti të drejtë mospërfshirjen në analizën e kryer prej tij të këtyre të ardhurave.

**15.14.** Në vijim të sa më sipër, Komisioni nuk i ka përfshirë të ardhurat nga llogaritë bankare edhe në analizën financiare që i përket krijimit të pasurive të paluajtshme. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar edhe këtë vlerësim të Komisionit. Në kushtet kur subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ, ndonëse kishte barrën e provës dhe kohë të mjaftueshme për të dokumentuar pretendimet e saj, nuk ka sjellë dokumentacion që do të provonte sasinë e të ardhurave të gjeneruara në Greqi, vlera e tyre mbeti deklarative. Për këto arsye, përfshirja në analizë e një vlere deklarative do të ishte e pabazuar, qoftë për shkak të mosprovueshmërisë së vlerës, qoftë për shkak të mospërmbushjes së testit të ligjshmërisë së tyre. Në përmbledhje, trupi gjykues i Kolegjit, sikurse edhe Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të ardhurat e pretenduara në vlerën prej 12.000.000 GRD nga puna në emigracion e bashkëshortit për periudhën 1991 – 1999 e, për pasojë, as edhe pasuritë e krijuara prej tyre në formën e depozitave bankare e, më tej, përdorimin e tyre për krijimin e pasurisë së paluajtshme objekt analize<sup>20</sup>.

**15.15.** Subjekti i rivlerësimit pretendon, po ashtu, se Komisioni ka përllogaritur dy herë kostot e arredimit, në vlerën 1.200.000 lekë. Nga aktet në fashikull, trupi gjykues vëren se ky pretendim është i pabazuar. Këto shpenzime të pavarura nga kostoja e ndërtimit, Komisioni i ka konsideruar në bazë të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, duke i shpërndarë

---

<sup>20</sup> Sipas akteve në fashikull rezulton se në datën 02.02.1998, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar 3.000.000 lekë, në ish-Bankën e Kursimeve. Në fund të vitit 2003, depozita arriti në shumën 6.029.205 lekë, nga të cilat 3.029.205 lekë janë rezultat i interesave të akumuluar [2.606.916 lekë] dhe një derdhje në dhjetor 2000 me vlerë 500.000 lekë pa përshkrim. Në kartelën e depozitës në Bankën e Kursimeve rezulton një derdhje (pa përshkrim të detajuar) në vlerën 500.000 lekë, por duke qenë se në po të njëjtën datë është akumuluar interes në vlerën 77.711 lekë, si derdhje është konsideruar diferenca. Në datën 31.12.2001, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë mbajtës i një depozite tjetër, në vlerën 1.393.021 lekë. Në datën 19.11.2002 vlera e kësaj depozite ka qenë 1.484.271 lekë. Në fashikull nuk janë administruar të dhëna lidhur me burimin e shtesave për periudhën janar 2002 - 18.11.2002 (67.569 lekë), përveç deklarimit të subjektit se depozita është shtuar nga interesat. Në datën 31.12.2003, depozita ka qenë në vlerën 1.034.864 lekë, për shkak të tërheqjeve të kryera nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Për periudhën 19.11.2002 - 31.05.2004, kjo depozitë është shtuar vetëm nga interesat e gjeneruara në vlerën 125.581,88 lekë. Subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë depozituar në datën 01.10.2001, shumën prej 350.000 lekësh në ish-Bankën e Kursimeve [Korçë], vlera e së cilës në datën 20.11.2002 rezulton në shumën prej 632.616 lekësh. Nuk ka të dhëna lidhur me burimin e shtesave në shumën prej 282.616 lekësh. Në datën 27.08.2004, kjo depozitë është mbyllur dhe tërhequr nga subjekti i rivlerësimit vlere prej 699.660 lekësh. Nga analiza e kryer në Kolegj për verifikimin e mundësisë së krijimit të depozitës 350.000 lekë në datën 01.10.2001 dhe kryerjen e shpenzimeve të jetesës, subjekti rezulton me balancë negative në shumën **13.809 lekë**, nëse në analizë përfshihet vetëm kjo depozitë. Nëse analiza kryhet e plotë duhet të përfshijë edhe shtesën në depozitën e bashkëshortit në dhjetor 2000 (rreth 500.000 lekë, nga të cilat shuma 77.711 lekë janë konsideruar si shtesë nga interesat e gjeneruara nga depozita dhe si depozitim është konsideruar diferenca prej 422.289 lekë), subjekti do të rezultonte me balancë negative **436.098 lekë**.

ekzaktësisht në kohë e vlera siç i ka specifikuar ajo<sup>21</sup> e më pas i ka kaluar barra e provës me rezultatet e hetimit administrativ. Në kushtet kur vetë subjekti i ka evidentuar këto shpenzime qartësisht si shpenzime mobilimi (ose arredimi) dhe i ka ndarë në kohë, duke u bazuar në kujtesën e saj, pretendimi në ankim se kjo vlerë përbën një shumë të përfshirë në kosto të tjera ndërtimi, tashmë, është i pakuptimtë.

**15.16.** Subjekti i rivlerësimit pretendoi më tej për mungesë shpjegimi metodologjike të mënyrës së përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës nga Komisioni për vitet 1994 - 1996. Nga aktet në fashikull, trupi gjykues vëren se ky pretendim është i bazuar pjesërisht. Në funksion të analizës financiare të mundësisë së blerjes së truallit nga subjekti në vitin 1996, Komisioni i ka konsideruar shpenzimet e jetesës së periudhës përkatëse në masën 70 % të të ardhurave vjetore të subjektit të rivlerësimit, në kushtet kur për këtë periudhë mungojnë të dhënat statistikore. Në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit<sup>22</sup>, për këto vite, për të cilat mungojnë standardet zyrtare nga INSTAT-i, trupi gjykues i përlllogariti shpenzimet e jetesës për subjektin, e cila ka qenë magjistrate në periudhën në fjalë, në masën 30 % të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit<sup>23</sup>. Meqenëse si pasojë e kësaj përlllogaritjeje, pamundësia financiare kundrejt krijimit të pasurisë truall me burime të ligjshme ulet ndjeshëm<sup>24</sup>, trupi gjykues i Kolegjit çmon ta konsiderojë krijimin e pasurisë truall të krijuar me burime të ligjshme, nën dritën e parimit të proporcionalitetit.

**15.17.** Pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit ka për fokus zbritjen e shpenzimeve të jetesës që janë llogaritur për të, për harkun kohor maj 1994 - mars 1995. Subjekti shpjegon se gjatë kësaj periudhe ka jetuar në Greqi, pasi ishte me leje barrë lindjeje dhe shpenzimet i përballonte bashkëshorti. Trupi gjykues vëren se ky pretendim nuk mban peshë në analizën financiare edhe duke u konsideruar i provuar nga dokumentet provues rrethorë [indirektë]<sup>25</sup> të sjellë, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë sasinë e të ardhurave të gjeneruara nga personi i lidhur/bashkëshorti e, si pasojë, as mundësinë e tij për të mbuluar shpenzimet e jetesës për 3 (tre) persona. Pa përsëritur sa është arsyetuar gjerësisht më sipër, trupi gjykues sjell në vëmendje që për vitin 1994 subjekti nuk provoi punësimin e bashkëshortit në Greqi. Për vitin 1995, siç është shtjelluar gjerësisht më sipër, subjekti solli akte të cilat nuk përmbushin kriteret e pranimit në ankim parashikuar nga disa dispozita të ligjit të zbatueshëm e u konsideruan pa peshë në zgjidhjen e çështjes, pasi sasia e të ardhurave të provuara ishte e papërfillshme dhe e pamjaftueshme edhe për të mbuluar shpenzimet e jetesës për një person të vetëm<sup>26</sup>. Për pasojë,

---

<sup>21</sup> Përgjigjet e pyetësorit standard të dërguar nga Komisioni, pyetja nr. 14, faqja 9.

<sup>22</sup> Shih vendimin orientues të Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit K. Selita [JR nr. 15/2021]. Shpenzimet e jetesës në Kolegj llogariten si vijon: për vitet deri në 1992 (përfshi vitin 1992), 100% e të ardhurave nga pagat; për vitet 1993-1999, 30% e të ardhurave nga paga; për vitin 2000, 9.000 lekë/muaj për person \* 3 persona; për vitin 2001, 8.411 lekë/muaj për person\*3 persona; për vitet 2002-2003, 7.822 lekë/muaj për person \* numrin e personave në familje.

<sup>23</sup> Përkatësisht, nga 276.990 lekë, në 118.710 lekë.

<sup>24</sup> Balanca negative që përftohet rezulton në vlerën 23.000 lekë, afërsisht.

<sup>25</sup> Sipas certifikatës së lindjes së lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Korçë, vërtetimit datë 20.10.2016 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe Librezës së Shëndetit të lëshuar nga autoritetet greke, rezulton që vajza e subjektit ka lindur në datën 07.07.1994, në Athinë. Po ashtu, rezulton që subjekti ka përfutur pagesa të reduktuara për periudhën qershor 1994 - mars 1995, që përkon me pagesën e barrë lindjes. Së fundmi, aktet që tregojnë kryerjen e vaksinave të vajzës në institucionet shëndetësore në Greqi, në katër data me distancë disajavëshe mes tyre në kohë, në periudhën kohore mes tetorit 1994 dhe marsit 1995.

<sup>26</sup> Shih edhe paragrafin 15.10 dhe 15.11, lidhur me mospërmbushjen e kriterit ligjor për pranimin në ankim të akteve të reja. Hipotetikisht, nëse aktet e dorëzuara së bashku me ankimin do të ishin sjellë si provë gjatë hetimit administrativ apo pranuar me ankimin, situata financiare nuk do të ndryshonte, pasi aktet e sjella provojnë



situata financiare mbetet e pandryshuar dhe pretendimi i subjektit, për të konsideruar shpenzimet e jetesës për këtë hark kohor të mbuluara tërësisht me të ardhurat e bashkëshortit në emigracion, nuk qëndron.

**15.18.** Subjekti i rivlerësimit pretendoi se për periudhën mars 1995 - tetor 1998 nuk ka pasur shpenzime, pasi ka jetuar me prindërit, të cilët kanë mbuluar edhe shpenzimet e jetesës. Përveç të ardhurave nga pensionet, prindërit gjeneronin të ardhura edhe nga aktiviteti bujqësor dhe shitja ambulante e produkteve bujqësore në tregun e qytetit të Korçës, në vitet 1992 -- 2006, duke realizuar të ardhura mesatarisht rreth 20.000 lekë/muaj, pretendon subjekti. Komisioni konkludoi që prindërit e subjektit të rivlerësimit gjendeshin në kushtet e pamundësisë së kursimit në vlerën prej (-) 491 235 lekësh në periudhën 1991 - 1999.

**15.19.** Pasi analizoi aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për këtë aspekt të këtij shkaku ankimi, qëndrojnë pjesërisht. Së pari, siç është arsyetuar në detaj më sipër, ky shkak ankimi rezulton i lidhur ngushtë me konkluzionin e Komisionit për balancën negative në krijimin e pasurisë truall. Trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se subjekti kishte mundësi ta mbulonte me burime të ligjshme investimin në këtë pasuri të paluajtshme [shtjelluar në paragrafin 15.17.] Për rrjedhojë, analiza e të ardhurave të prindërve të subjektit të rivlerësimit, në kontekstin e analizës së krijimit të kësaj pasurie, është pa peshë përcaktuese në zgjidhjen e çështjes. Për këtë arsye, edhe aktet e sjella nga subjekti me parashtrimet e datës 10.04.2023, përmbledhur më sipër në paragrafin 8, janë pa peshë në zgjidhjen e çështjes dhe u vlerësuan nën dritën e kriterëve të germave “b” dhe “d”, të pikës 6, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, të cilat përcaktojnë si vijon:

*“[...] 6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit [...]”.*

**15.20.** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë edhe një shumë prej 400.000 lekësh, të dhuruar nga vëllai në vitin 2005, për ndërtimin e shtëpisë<sup>27</sup>. Komisioni ka konkluduar se vëllai ka qenë në pamundësi financiare të dhuronte këtë shumë në kushtet kur subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj shume. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se vëllai i saj ka pasur mundësi financiare për të dhuruar këtë shumë, pasi ka gjeneruar të ardhura ndër vite në emigracion në Greqi.

**15.21.** Nga aktet në fashikull, trupi gjykues konstaton se konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar ligjshmërinë e burimit, sipas kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ nuk provojnë të ardhura, të cilat do të mundësonin kontributin e tij nëpërmjet

---

*përfitimim e të ardhurave në vlerën 590 euro (afërsisht) për vitin 1995, ndërsa sipas EUROSTAT, minimumi jetik për një person në Greqi për vitin përkatës është 3.125 euro.*

<sup>27</sup> Ky aspekt i deklaratës së pasurisë së subjektit, siç shjellohet edhe më tej në këtë vendim, është trajtuar veçmas nga Komisioni, ndonëse nën dritën e analizës financiare ka sjellë pasojë mbi mundësinë e krijimit të pasurisë së paluajtshme objekt i kësaj analize.

dhurimit e, për pasojë, as edhe ligjshmërinë e tyre, sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Analiza mbi të cilën bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

15.22. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision vërtetime nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në Greqi, nga të cilat, ndonëse rezulton se vëllai [z. I. G.] ka punuar në Greqi në periudhën 1998 – 2001, nuk ka të dhëna për nivelin e të ardhurave të realizuara. Për vitin 2002, aktet e sjella provojnë të ardhura në shumën 3.123, 82 euro dhe 379, 10 euro në vitin 2003<sup>28</sup>. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe një librezë punësimi të të vëllait, lëshuar nga autoritetet e sigurimeve shoqërore në Greqi në vitin 2002, e cila paraqitet me probleme të formës<sup>29</sup>. Edhe nëse abstragohet nga problemet e formës që paraqesin dokumentet, nga përmbajtja e tyre rezulton se personi tjetër i lidhur ka qenë në kushtet e mungesës së burimeve për të përballuar edhe shpenzimet jetike, në periudhën kohore 1998 – 2003, në Greqi, për veten dhe familjen e tij. Në kushtet kur të ardhurat e referuara në dokumentacion rezultojnë nën nivelin minimal jetik<sup>30</sup> për një familje me katër persona/një person të vetëm, për secilin vit për periudhën në fjalë, 1998-2003, pretendimi i subjektit mbeti i pambështetur në prova edhe duke i dhënë peshë provuese përmbajtjes e duke abstraguar nga problemet me formën. Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të justifikojë me burime të ligjshme dhurimin nga i vëllai [z. I. G.], në shumën prej 400.000 lekësh, në vitin 2005.

15.23. Në përmbledhje të sa më sipër, pas kontrollit të vendimit të Komisionit sipas shkaqeve të ankimit, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se subjekti i rivlerësimit mbetet me mungesë burimesh të ligjshme për të krijuar pasurinë objekt analize. Shkaqet e ankimit të subjektit që u gjetën të bazuara nuk arrijnë të ndryshojnë vlerën negative të balancës së konstatuar nga Komisioni. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë për sipërfaqen e ndërtimit në kundërshtim me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e po këtij ligji.

#### *C/2. Analiza financiare për vitin 2008*

16. Fillimisht e në parantezë, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje që nën titullin “Përfitimet” Komisioni rezulton t’i ketë dedikuar një pjesë të posaçme një shume monetare në vlerën 1.000.000 lekë, të deklaruar të dhënë nga babai i personit të lidhur në vitin 2008 dhe kthyer në vitin 2009 – të cilën [Komisioni] nuk e ka kategorizuar në asnjë nga cilësitë ligjore si parakusht për krijimin e cilësisë së *personit tjetër të lidhur*, sipas ligjit nr. 84/2016 -- sikurse edhe dhuratën monetare nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, analizuar më sipër nga trupi gjykues i Kolegjit [shih edhe shpjegimin në poshtëshënimin nr. 35]. Më tej, në paragrafin e numërtuar nr. 9, Komisioni i është rikthyer sërish analizës së pasurive të krijuara nga subjekti

<sup>28</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Kostur, sipas komentit në dokument.

<sup>29</sup> Akteve të sjella nga subjekti iu mungon vula apostile, ndonëse janë fotokopje të njehsuara me origjinalin nga noter shqiptar dhe përkthyer në shqip nga përkthyes në Shqipëri. Edhe aktet e sjella pas seancës dëgjimore, në datën 06.07.2020, dërguar nga subjekti i rivlerësimit në rrugë elektronike [kopje të librezave/vërtetimeve të punësimit], të lëshuara nga autoritetet e sigurimeve shoqërore në Greqi në vitet 1998 - 2002, rezultojnë pa vula apostile, por janë përkthyer në shqip nga përkthyes në Shqipëri.

<sup>30</sup> Sipas akteve, personi tjetër i lidhur ka gjeneruar në total ekuivalentin e 19.168 euro. Shpenzimet jetike në Greqi për periudhën, sipas EUROSTAT, përllogariten në 75.741 euro, për një familje prej katër personash dhe 36.547 euro për një person, të cilat përkatësisht përllogariten në mungesë burimesh të personit të lidhur në vlerën (-) 56.572 euro dhe/ose (-)17.738, për të përballuar shpenzimet jetike.

ndër vite, së bashku me analizën e depozitave bankare të krijuara në vitin 2008 nga subjekti i rivlerësimit. Për qartësi, në këtë arsyetim, trupi gjykues i Kolegjit çmon të ndjekë radhën e argumenteve sipas logjikës që dikton natyra e tyre dhe shkaqet e ankimit. Në këtë kontekst, dhurimi i shumës monetare nga vëllai i subjektit, deklaruar i kryer në vitin 2005, u analizua në kuadër të pasurisë së paluajtshme të sipëranalizuar. Dy aspektet e tjera, të cilat i përkasin në thelb analizës financiare të vitit 2008 e, konkretisht, shuma e *përfitur* nga babai i personit të lidhur dhe depozitat bankare të subjektit, në mungesë të një pjese të dedikuar analizës financiare, shtjellohen si specifikuar më sipër, si pjesë e analizës financiare për vitin 2008.

17. Në lidhje me shumën monetare të *përfitur* nga babai i personit të lidhur, Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka përmbushur detyrimin e parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit, pasi personi tjetër i lidhur ka qenë në pamundësi financiare për të krijuar këtë likuiditet. Për pasojë, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, kjo shumë nuk u përllogarit e përfitur në vitin 2008, sikurse as kthimi i saj në vitin 2009. Babai i personit të lidhur rezultoi me mungesë burimesh në vlerën (-) 864.073 lekë për krijimin e këtij likuiditeti. Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të kryer shpenzimet, *shoqëruar me dokumentacion justifikues për vitin përkatës*<sup>31</sup>. Pasi Komisioni ka analizuar edhe mundësinë e subjektit për të krijuar depozitën prej 4.000 USD, referuar analizës financiare në faqen 34 të vendimit tij, konkludoi mungesë burimesh në total në vlerën (-) 1.087.208 lekë, për vitin 2008. Pavarësisht nga sa arsyetuar në analizë, Komisioni ka përllogaritur në ngarkim të subjektit *vetëm* vlerën 100.000 lekë.

17.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se shuma e përfitur nga vjehri nuk ka krijuar pasuri dhe që ai ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga kursimet e tij që nga viti 1987, nga prodhimet bujqësore e blegtorale, nga shitja e bagëtive dhe nga ndihma e tre fëmijëve, të cilët punonin emigrantë në Greqi. Ndërsa fillimisht ka paraqitur një deklaratë noteriale të vitit 2009, lëshuar nga vjehri, sipas të cilit nuk referohet kthimi i shumës, në vitin 2019 – gjatë procesit të rivlerësimit -- deklaruesi ka pretenduar se shuma në fjalë, e investuar në bono thesari nga personi i lidhur me subjektin, në shkurt 2008 – i është kthyer deklaruesit [babait të personit të lidhur]. Për sa i përket krijimit të depozitës në prill 2008, subjekti pretendon në ankim se burim kanë qenë kursimet e vitit 2007, të cilat nuk i ka deklaruar në deklaratën periodike përkatëse për shkak harrese.

17.2. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi aktet në fashikull, konstaton që konkluzioni i Komisionit qëndron. Subjekti i rivlerësimit rezulton të mos ketë provuar burimin e ligjshëm të krijimit të secilës prej dy shumave, për të cilat është kërkuar të sjellë dokumente e shpjegime. Në analizën e kryer në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve të vitit përkatës, në vlerën (-) 1.031.129 lekë – një diferencë e papërfillshme midis analizës së Komisionit dhe analizës së Kolegjit<sup>32</sup> me balancën negative respektive të konstatuar nga

<sup>31</sup> Faqe 29 dhe 30 e vendimit të Komisionit.

<sup>32</sup> Diferencat ndërmjet pamjaftueshmërisë financiare për vitin 2008, sipas analizës së kryer nga Komisioni dhe analizës së Kolegjit, në vlerën 56.079 lekë, vijnë si rezultat i zërave:

a. “(D) Shtesa/Pakësime në gjendjet e llogarive bankare gjatë vitit” - për shkak të përdorimit të kurseve të ndryshme të këmbimit (Komisioni ka përdorur kursin mesatar fixing të dhjetorit 2008, përkundrejt Kolegji që ka përdorur kursin e këmbimit fixing, sikurse datë 31.12.2008);

Komisioni. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, qoftë për moskrijim të ndonjë pasurie prej saj si rrjedhojë e shumës në fjalë [depozituar në bono thesari] apo për krijimin e depozitës me likuiditete jashtë sistemit bankar të padeklaruar në vitin 2007 për shkak të harresës, janë të pambështetura në dokumentacion dhe të pabazuara në ligj. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

17.3. Së pari, nga dokumentacioni në fashikull rezultojnë faktet që vijojnë:

a. Depozita në bono thesari, në vlerën 1.000.000 lekë është çelur në datën 07.02.2008 dhe mbyllur në datën 13.02.2009, nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit.

b. Në deklaratën e interesave periodike/vjetore për vitin 2008, nuk është deklaruar sa më sipër, ndërsa në deklaratën e interesave periodike/vjetore për vitin 2009, që mban datën 25.03.2010, bashkëshorti ka deklaruar se fondet i janë kthyer të atit, pasi e ka mbyllur këtë depozitë në vlerën 1.100.000 lekë dhe ka referuar procesverbalin e hartuar në ILDKPKI.

c. Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar shumën prej 80.787 lekësh, përfituar nga depozita në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, e hapur për llogari dhe me të ardhurat e babait, referuar në deklaratën noteriale të tij që mban datën 29.10.2009.

d. Subjekti i rivlerësimit është thirrur për të dhënë shpjegime në ILDKPKI më 30.10.2009, për shkak të pasaktësive në deklaratimet e saj në vitet 2004, 2005 dhe 2008, me fokus, ndër të tjera, edhe këtë depozitë.

e. Babai i personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit ka lëshuar një deklaratë noteriale një ditë përpara dhënies së shpjegimeve prej saj në ILDKPKI, përkatësisht më 29.10.2009, në të cilën shprehet se i ka dhënë të birit të tij një shumë prej 1.000.000 lekësh në janar të vitit 2008. Në deklaratë nuk ka asnjë informacion për arsyen e dhënies së shumës, burimin, nëse ishte dhënë kundrejt një afati, çfarë ajo përfaqëson apo pritshmëritë prej saj.<sup>33</sup>

f. Gjatë hetimit në Komision, subjekti ka paraqitur një deklaratë të dytë noteriale [më datë 20.06.2019], nga i njëjti familjar [babai i personit të lidhur], në të cilën *tashmë* specifikohen për herë të parë detaje për deklaratën e tij noteriale të hartuar 10 vite më parë. Sipas këtyre detajeve, fondet prej 1.000.000 lekësh përbënin kursime familjare që i ishin dhënë të birit me qëllim depozitimin në një institucion financiar dhe më pas shuma i ishte kthyer<sup>34</sup>.

17.4. Nga aktet dhe kronologjia e referuar më sipër, rezulton mospërputhje serioze mes deklaratave noteriale në detajet thelbësore. Parë në kontekstin e momenteve kur ato janë

---

b. "Të ardhura A. Q." – në analizën e kryer në Kolegj, nuk janë përfshirë si të ardhura interesat nga investimi në Bono Thesari, kryer nga bashkëshorti i subjektit. Këto të ardhura janë përfshirë në analizën e Komisionit, megjithëse subjekti ka deklaruar se ky investim është kryer nga të ardhurat e vjehrrit dhe se këto fonde dhe interesat e gjeneruara prej tyre nuk janë përdorur nga familja e saj, por i janë kthyer babait të bashkëshortit; "Shpenzime për shtesë investimi në Bono Thesari - 2008 – A. Q.", në vlerën 100.000 lekë – kjo vlerë e deklaruar nga subjekti si shtesë e familjes së saj për investimin në Bono Thesari me fondet e vjehrrit, në analizën e kryer në Kolegj nuk është përfshirë në zërin e shpenzimeve sepse është pasqyruar në zërin "(D) Shtesa/Pakësime, në gjendjet e llogarive bankare gjatë vitit".

<sup>33</sup> "Deklaruesi deklaroi nën pergjegjesinë e tij personale dhe në dijeni të plote të pasojave që sjell një deklarament pavarësisht se: në janar të vitit 2008 I kam dhënë djalit tim të quajturit A. S. Q. vlerën prej 1 000 000 njemiljon leke të reja [...]" – deklarata noteriale nr. rep. {\*\*\*} dhe nr. kol. {\*\*\*}, datë 29.10.2009 e z. S. Q., përpara noterës F. L., Ersekë. [Gabimet e drejtshkrimit/pikësimit janë si në origjinal].

<sup>34</sup> "[...] Kete shume ia kam dhene per ti depozituar per llogarine time ne nje banke qe do ta shikonte ai vete te arsyeshme dhe deklaroi se kete shume e kam mbledhur nga kursimet e mija familjare ne vite. — Kjo shume se bashku me interesat bankare pasi eshte mbyllur depozita me jane kthyer perseri nga djali im A. S. Q. [...]" -- Deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.06.2019 e z. S. Q., hartuar përpara noterës F. L., Ersekë. [Gabimet e drejtshkrimit/pikësimit janë si në origjinal].

hartuar, përkatësisht gjatë kontrollit të cilit subjekti i ishte nënshtruar nga ILDKPKI-ja, në bazë të nenit 27 të ligjit nr. 9049/2003, si dhe në një fazë të avancuar të procesit të rivlerësimit, qartazi deklaratat kanë për synim përmirësimin e situatës së subjektit të rivlerësimit në dy kohët e ndryshme. Përpos këtij konstatimi, fakti që nuk ka asnjë gjurmë dokumentare të lëvizjes së likuiditeteve mes këtyre dy individëve në secilin kah, dhe që shpjegimet kanë ardhur vetëm si pasojë e konstatimit të ILDKPKI-së, përbëjnë një argument shtesë që e bën pretendimin se ato i përkisnin vjehrrit të subjektit, jo bindës. Së fundmi, edhe nga kontrolli i analizës së Komisionit që u krye në Kolegj, rezultoi që vjehri i subjektit është në pamundësi të mbulimit të shumës me burime të ligjshme. Pavarësisht nga kontradiktat e sipërreferuara, vlera për të cilën Komisioni ka konstatuar mungesë burimesh të subjektit për vitin 2008 është përlllogaritur në 100.000 lekë, ndërkohë që një sërë rrethanash të tjera dhe hapash hetimorë të ndërmarrë duket se janë bazuar mbi pikëpyetje që përfshijnë të gjithë shumën.

17.5. Në kushtet kur konkluzioni i Komisionit, pavarësisht analizës së kryer dhe konkluzionit në vendim, në fakt nuk ka pasjellë asnjë ndikim në kontrollin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit apo edhe të masës disiplinore të marrë për të, trupi gjykues e gjen të panevojshme të ndalet në një analizë të mundësisë financiare të vjehrrit të subjektit të rivlerësimit për të krijuar *kursime familjare ndër vite*, për të krijuar depozitën në fjalë. E thënë me fjalë të tjera, ndonëse Komisioni ka hetuar për gjithë rrethanat e sipërpërmbledhura ka konstatuar se subjekti nuk ka provuar me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës prej 1.000.000 lekësh dhe e ka cilësuar vjehrrin e subjektit *person tjetër të lidhur*<sup>35</sup>, në analizën financiare përfundimtare – në faqen 33 të vendimit -- kjo shumë nuk është përfshirë në *asnjë* cilësi dhe për *asnjë* efekt, në kushtet kur shpenzimet janë në vlerën 653.010 lekë. Është po ashtu e paarsyetuar mbi ç'bazë vjehri i subjektit ka përmbushur kriteret për të qenë person tjetër i lidhur në konkluzionin e faqes 29 të vendimit të Komisionit. Në vendim nuk gjendet një shpjegim nëse në një fazë më të hershme Komisioni e ka konstatuar këtë shumë si dhurim apo hua. Komisioni ka përfshirë në analizën e pasqyruar në tabelë, në ngarkim të subjektit, vetëm shumën prej 100.000 lekësh për sa i përket kësaj depozite.

17.6. Në vijim të shkaqeve të ankimit për analizën e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit pretendoi se mosdeklarimi i gjendjes *cash* në fund të vitit 2007, si burim i depozitës prej 4.000 USD në ish-Bankën e Amerikane në vitin 2008, me burim nga pagat e subjektit të rivlerësimit, ka ndodhur për shkak të një gabimi njerëzor *harrese të paqëllimshme*. Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit në 3 mujorin e parë të vitit 2008 kishte pamundësi financiare prej (-) 153.152 lekësh, për shtimin e kësaj depozite.

17.7. Nga analiza e akteve në fashikull nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në rrethanat konkrete, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit për të përlllogaritur e përfshirë likuiditete të cilat ajo *nuk* i ka deklaruar në fund të vitit 2007, pavarësisht detyrimit të shprehur të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, është i pabazuar në gjuhën e shprehur të ligjit dhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit në zbatim të tij. Konkretisht, pavarësisht nga ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarimit, në rubrikën përkatëse, faqja 3 e formularit, që i përket pasqyrimin të shtesave dhe ndryshimeve të interesave privatë

<sup>35</sup>Shih faqen 29 të vendimit të Komisionit: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2020/08/Vendim-Rozeta-Qirjaqi.pdf>

dhe pasurive të paluajtshme e të luajtshme, ligji në mënyrë konsistente ka kërkuar që subjektet deklaruese të shprehen për [...] ndryshimet (“shtesa dhe pakësime” nga “deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit”, që lidhen me zyrtarin, bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë [...]). Legjislacioni në fuqi ka qenë i qartë, duke parashikuar që deklaratat përbëjnë dokumente zyrtare dhe mospërbushja e detyrimit për të pasqyruar saktësisht të ardhurat, passjell pasoja.

17.8. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, personi i lidhur/bashkëshorti ka deklaruar si burim krijimi *pagat e bashkëshortes*, për sa i përket shtesës së kësaj depozite me 4.000 USD. Nga ana tjetër, në vitin pararendës, 2007, subjekti ka pasqyruar shtesat në likuiditete në bankë, gjë që nënkupton ndërgjegjësimin e saj të plotë për çfarë kërkohej të deklaronte – e konkretisht, shtesat apo pakësimet e pasurive të luajtshme, në rastin konkret. Ky interpretim rezulton të ketë qenë konsekuent në secilën deklaratë periodike. Pretendimi i subjektit në ankim se formulari i kohës nuk kërkonte pasqyrimin e gjendjes, për këtë arsye, duket i pakuptimtë e kontradiktor me deklaratimet e kryera prej saj ndër vite. Në kushtet kur subjekti ka deklaruar shtesat e ndryshimet e likuiditeteve në bankë, e njëjta mënyrë deklarimi do duhet të kishte gjetur zbatim edhe nëse dispononte *cash* jashtë sistemit bankar. Duke qenë se për herë të parë subjekti është shprehur për *cash* jashtë sistemit bankar në pyetësorin nr. 3, ky deklarim nuk ka ndodhur në deklaratën periodike vjetore, trupi gjykues konstaton që konkluzioni i Komisionit është i drejtë.

17.9. Në analizën e kryer në Kolegj, subjekti rezulton me mungesë burimesh për krijimin e depozitës në prill të vitit 2008 dhe konfirmohet *minimalisht* balanca negative e konstatuar nga Komisioni, në vlerën prej (-) 153.152 lekësh, për krijimin e kësaj depozite. Sjellim në vëmendje që ndonëse në shpjegimin narrativ të tabelës në faqen 32 të vendimit të Komisionit referohen *shpenzime jetese për 3 muaj*, vlera e përllogaritur prej 34.155 lekësh i përket një muaji, për tre persona<sup>36</sup>. Në kushtet që familja e subjektit të rivlerësimit në vitin 2008 përbëhej nga katër persona dhe periudha kohore janar-mars 2008, përpara krijimit të depozitës, përbëhet nga të paktën tre muaj, ekziston një mospërputhje në analizë, e cila do të konsiderohet pa ndikim në vlerësimin përfundimtar, nën dritën e mospërkeqësimit të situatës së subjektit në ankim. Në përfundim, pas analizës financiare të kryer në Kolegj për vitin 2008, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh të ligjshme në shumën prej (-) 1.031.129 lekësh.

17.10. Për sa më sipër, bazuar në kontrollin e analizës financiare të kryer nga Komisioni në vendim, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar pasurinë e sipërcituar, sikurse edhe shpenzimet e kryera në vitin 2008.

#### Ç. Kriteri i kontrollit të figurës

18. Komisioni ka marrë masën disiplinore të shkarkimit për subjektin edhe për kriterin e kontrollit të figurës, pasi ka konstatuar se subjekti gjendet në kushtet e nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 2, të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016. Në kushtet që në deklaratën për kontrollin e figurës, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar procedimin penal në ngarkim të nipit të

---

<sup>36</sup> Shpenzimet e jetesës për tre (3) muaj për një familje me katër (4) persona, përllogariten në vlerën 136.620 lekë, referuar shkresës së INSTAT-it dërguar ILDKPKI-së dhe më pas përcjellë institucioneve të rivlerësimit, më datë 04.03.2019. Nëse përllogaritja do të ishte kryer saktë, balanca negative për krijimin e kësaj pasurie do të ishte (-)199.737 lekë.

saj për vepra penale që përfshihen nën krimin e organizuar, Komisioni ka konkluduar mospërmbushje të kërkesës për deklarim të plotë e me vërtetësi. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se rrethanat e kryerjes së veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, në ngarkim të nipit të saj [djali i vëllait], janë jashtë qëllimit të ligjit nr. 10192/2009, dhe se nuk ka pasur kontakte me nipin, sikurse as dijeni për veprimet e tij.

**18.1.** Nga analiza e akteve në fashikull dhe dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në rrethanat konkrete, si dhe shkaqeve të ankimit të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që vendimi i Komisionit, pavarësisht gabimeve materiale në referimin e të dhënave/datave<sup>37</sup>, është i bazuar. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, qoftë ato bazuar në interpretimin e ligjit dhe përkufizimeve të përcaktuara nga neni 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, sikurse edhe ato që përpriqen të parashtrojnë një marrëdhënie familjare, e cila përjashtonte kontaktet dhe dijeninë e saj për arrestimin në flagrancë, fillimin e procedimit penal dhe masat përkatëse të sigurisë, përfshirë arresti në burg, të caktuar përgjatë këtij procedimi, përfshirë edhe gjatë kohës kur ajo ka plotësuar deklaratën për kontrollin e figurës, janë të pabazuara dhe jobindëse, respektivisht. Arsytimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

**18.2.** Së pari, nga aktet në fashikull rezulton se Komisioni ka ardhur në dijeni të procedimit penal të nipit të subjektit pas dy denoncimeve nga individë<sup>38</sup>, që, ndër të tjera, pretendonin që subjekti ka ushtruar ndikim në Gjykatën e Apelit Korçë për të lehtësuar pozitën e nipit në këtë procedim. Nga hetimi i kryer nga Komisioni në vijim të këtyre indicieve, ka rezultuar se nipi i subjektit të rivlerësimit është arrestuar në maj 2016, si person i dyshuar për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim. Më 07.04.2017, ai është shpallur fajtor dhe dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë<sup>39</sup> me 4 vjet e 6 muaj burgim për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, të kryer në bashkëpunim. Vendimi i shkallës së parë u ndryshua në datën 02.11.2017 nga Gjykata e Apelit Korçë<sup>40</sup>, e cila vlerësoi se vepra penale nuk ishte kryer në bashkëpunim dhe uli dënimin në 2 vjet e 6 muaj burgim. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në deklaratën e kontrollit të figurës në funksion të procesit të rivlerësimit, në janar 2017, procedimin në fjalë në ngarkim të nipit, të nisur pas arrestit në flagrancë në maj 2016 e në proces gjyqësor gjatë vitit 2017.

**18.3.** Për shkak të sa më sipër, Komisioni vlerësoi se ky fakt e ngarkonte subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi për mosplotësim të saktë dhe me vërtetësi të deklaratës për kontrollin e figurës, duke zbatuar për pasojë prezumimin në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në arsyetimin e Komisionit, duke abstraguuar nga mungesa e pretenduar e kontakteve, për shkak të detyrës që kryente, nuk është e besueshme që subjekti nuk është informuar nga familjarët apo kolegë, për procedimin penal të një anëtarit të familjes, që përfshihet në rrethin e personave për të cilin ajo kishte detyrim për deklarim.

**18.4.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se asnjë nga dy argumentet e parashtruara nga subjekti në ankim apo edhe gjatë hetimit administrativ nuk është i bazuar. Konkretisht, vepra penale objekt

---

<sup>37</sup> Faqe 38 e vendimit – Komisioni ka referuar gabim gjithë kronologjinë kohore të procedimit penal në ngarkim të nipit të subjektit duke e vendosur në vitin 2015 dhe 2014, ndërkohë që arresti në flagrancë ka ndodhur në maj 2016 dhe vendimet e gjykatave të dy shkallëve, në vitin 2017.

<sup>38</sup> Denoncimi i dërguar nga znj. V. P., datë 12.12.2019 dhe denoncimi i dërguar nga znj. E. M., datë 21.02.2020.

<sup>39</sup> Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.04.2017. Në datën 08.05.2016, ndaj të nipit ishte marrë masa e sigurimit arrest në burg nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë [vendimi nr. {\*\*\*}, datë 08.05.2016].

<sup>40</sup> Vendimi nr. {\*\*\*}, datë 02.11.2017, i Gjykatës së Apelit Korçë.

procedimi -- *prodhimi dhe shitja e narkotikëve* -- parashikuar nga neni 283, pika 1 e Kodit Penal, është një ndër veprat penale të përfshira në fushën e zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 10192/2009<sup>41</sup>. Rrjedhimisht, nën dritën e parashikimeve të nenit 3, pika 15 lexuar bashkë me nenin 35, pika 1 dhe shtojca 3, pjesa 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, procedimi penal për këtë vepër e bën nipin e subjektit të rivlerësimit *person të përfshirë në krimin e organizuar* e, për pasojë, shoqërohet me detyrimin për deklaram prej saj. Ky deklaram nuk ka ndodhur. Pretendimet e subjektit, lidhur me natyrën e qëllimin e ligjit antimafia [nr. 10192/2009, i ndryshuar], kundrejt veprimeve për të cilat është arrestuar në flagrancë, proceduar penalisht e gjetur fajtor nipi i saj, nuk bazohen në përkufizimin ligjor për rrethin e personave që cilësohen të përfshirë në krimin e organizuar, sikurse as me rrethanat konkrete. Për sa kohë, vepra penale përfshihet në rrethin e veprave të parashikuara *shprehimisht* nga neni 3, pika 1 e ligjit nr. 10192/2009, një individ që është proceduar penalisht dhe, në rastin konkret, nuk është në diskutim pafajësia, plotëson kriteret për t’u deklaruar si person i përfshirë në krimin e organizuar<sup>42</sup>. Në kushtet që lidhja mes subjektit dhe djalit të vëllait është gjini e shkallës së tretë<sup>43</sup> e, për rrjedhojë, brenda rrethit të katërt të gjinisë parashikuar nga shtojca 3, pjesa nr. 5, germa “b” të rrethit të të afërmeve, për të cilët subjektet kanë përgjegjësi deklarimin, trupi gjykues çmon të mos ndalet më tej në këtë aspekt të marrëdhënies.

**18.5.** Në procesin e kontrollit të saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimeve, neni 38 i ligjit nr. 84/2016, parashikon edhe nevojën për analizë e, nëse është rasti, zbatimin e rrethanave lehtësuese apo rënduese, parashikuar në pikat 5, 6 dhe 7 të kësaj dispozite. Duke zbatuar këto rregullime normative në rrethanat konkrete të faktit, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi që subjekti nuk është bindës për padijeninë e procedimit penal të nipit, hapat proceduralë të të cilit, në momentin e plotësimit të deklaratës për figurën, ishin në zhvillim e sipër për një periudhë kohore prej thujse (8) muaj – arrestimi në flagrancë mban datën 04.05.2016. Nëse mbahet në konsideratë që ky procedim ndodhte në Korçë, ku subjekti ka ushtruar thujse jetën e saj profesionale nga viti 1989, ky pretendim humbet kredibilitetin edhe më tej.

**18.6.** Konkretisht, në vijim të sa më sipër, trupi gjykues thekson se pretendimet e subjektit se padijenja e saj ishte pasojë e shkëputjes së kontakteve me familjen e vëllait [të ndjerë], pas vitit 2015 – e, për pasojë, ka vend për zbatim të rrethanave lehtësuese të nenit 38, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 -- është jobindës, nëse analizohen rrethanat në tërësi e harmoni me njëra-tjetrën. Së pari, sepse ndërsa te vlerësimi i pasurisë subjekti paraqet një marrëdhënie të ngushtë familjare me vëllanë, të favorshme për të, meqenëse është dashamirësia e vëllait [dhe familjes së tij] që mundëson përfitime materiale për subjektin, në aspektin tjetër të procesit të rivlerësimit, te kriteri i figurës, subjekti paraqet të kundërtën, pretendon distancim të plotë nga e njëjta familje, në një moment kyç të jetës së nipit të saj. Siç është arsyetuar më sipër në

<sup>41</sup> Neni 3, pika 1, germa “ç” e ligjit nr. 10192/2009, parashikonte: “1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për: [...] ç) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenin [...] 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal. [...]”.

<sup>42</sup> Neni 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, parashikon: “[...] Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, [...] me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata, pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet. [...]”.

<sup>43</sup> Shtjelluar në vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 00-2013-897 (219), me fokus paragrafin 17.2. [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Viti\\_2013\\_1575\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Viti_2013_1575_1.php).



analizën e shkaqeve të ankimit për vlerësimin e pasurisë, subjekti ka pretenduar se vëllai e familja e tij kanë kontribuar rregullisht ndër vite, në drejtim të mirëqenies financiare të subjektit. Kjo ndihmë ka përfshirë kontribut real të vëllait në ndërtimin e shtëpisë së saj pa pagesë, kontribut monetar nëpërmjet dhurimit të shumës monetare prej 400.000 lekësh, duke i ofruar qëndrim në shtëpinë e tij në Greqi, personit të lidhur/bashkëshortit, gjatë punësimit atje e, së fundmi, duke mundësuar përcjelljen e provave rrethore për pagesat e mundshme nga punësimi i bashkëshortit në Greqi.

**18.7.** Përkundër këtyre argumenteve të saj te kontrolli i pasurisë, te kontrolli i figurës, pasi është përballur me gjetjet e Komisionit, subjekti përpiket të argumentojë një marrëdhënie aq të distancuar, sa për tetë (8) muaj ajo nuk mësoi në asnjë formë nga familjarët për procedimin penal të nipit, pavarësisht nevojës që mund të ketë pasur familja për njohuritë e saj profesionale në drejtësinë penale. Së dyti, padijenja bëhet akoma më pak bindëse nën dritën e funksionit zyrtar që ka mbajtur subjekti në periudhën kohore në fjalë. Në kushtet kur organet e drejtësisë, pjesë e të cilave është edhe vetë subjekti, pikërisht në juridiksionin gjyqësor në të cilin ajo punon prej vitit 1991, në të dy shkallët e prokurorisë, kishin nisur procedim për një vepër penale shumë serioze në ngarkim edhe të nipit të saj, është e vështirë të pranohet pretendimi se asnjë burim zyrtar apo informal nuk i mundësoi njohjen e këtij fakti, minimalisht edhe për shkak të organizimit hierarkik të prokurorisë, sipas ligjit të kohës<sup>44</sup>. Në vitin 2016, kur nisi procedimi penal, subjekti ishte një ndër dy (2) prokuroret e Prokurorisë së Apelit Korçë, institucion i cili më pas ishte palë në gjykimin në shkallë të dytë, siç rezulton nga vendimi i Gjykatës së Apelit në nëntor 2017.

**18.8.** Trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi që aktet shkresore të sjella së bashku me parashtrimet<sup>45</sup> nuk përmbushin testin e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, në kushtet kur nuk rezulton ndonjë arsye për paraqitjen e tyre në ankim. Pavarësisht nga ky vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se këto akte gjithsesi do të ishin të panevojshme dhe kategorizoheshin, sipas dispozitave të nenit 49, pika 6, germa “d” e ligjit nr. 84/2016, nën dritën e arsytimit të shtjelluar më sipër në paragrafin 18.7. Këto argumente të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit i vlerësoi si përpjekje e subjektit për të favorizuar situatën e saj ligjore në procesin e rivlerësimit. Po ashtu, pajisja e subjektit të rivlerësimit me certifikatë sigurimi të personelit, që kryhet për të lehtësuar kryerjen e detyrave përkatëse nga subjektet magjistratë, nuk e kushtëzon vendimmarrjen e trupit gjykues, bazuar në konsideratë të të gjithë faktorëve të tjerë në funksion të rivlerësimit të kriterit të kontrollit të figurës. Në këto kushte, trupi gjykues vendosi të mos pranojë certifikatën si provë në ankim, bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

**18.9.** Në përmbledhje të këtij arsytimi për kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar procedimin penal të nipit J. G., në vitin 2016, për prodhim dhe shitje të narkotikëve, nën dritën e përcaktimit të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, ligjit 10192/2009 dhe pjesës 5 të Deklaratës për Kontrollin e Figurës [shtojca 3 e ligjit nr. 84/2016]. Për rrjedhojë, formulari i deklarimit nuk është i plotë dhe i besueshëm, sipas parashikimeve të nenit 38, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

- 19.** Për sa më sipër, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë të pasurisë, sipas përcaktimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe të mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të analizuara, parashikuar nga germa “b” të po këtij neni e ligji, për të krijuar

<sup>44</sup> Ligji nr. 97/2016, që përcaktoi një qasje të re në mënyrën e funksionimit të prokurorisë, bazuar në barazinë e prokurorëve, hyri në fuqi më 22 nëntor 2016.

<sup>45</sup> Deklaratat notoriale të lëshuara nga daja dhe tezja e subjektit të rivlerësimit, më datë 24.03.2023, si dhe certifikata e sigurimit të personelit për subjektin e rivlerësimit (CSP), lëshuar nga DSIK më 08.01.2023.

pasurinë e sipërcituar, sikurse edhe shpenzimet e kryera në vitin 2008. Balanca negative e konstatuar në Kolegjin është në vlerën (-) 8.692.060 dhe (-) 1.031.129 lekë, respektivisht.

20. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar procedimin penal të nipit, në vitin 2016, për prodhim dhe shitje të narkotikëve, nën dritën e përcaktimit të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, ligjit nr. 10192/2009 dhe pjesës 5 të Deklaratës për Kontrollin e Figurës [shtojca 3 e ligjit nr. 84/2016]. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se formulari i deklarimit nuk është i plotë dhe i besueshëm, parashikuar nga neni 38, pika 6, germa “a” dhe neni 39 i ligjit nr. 84/2016. Asnjë nga shpjegimet kontradiktore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në faza të ndryshme të procesit, në prapësim të këtij konkluzioni dhe barrës së provës kaluar gjatë procesit të kryer në Komision, nuk u gjat bindës.
21. Në përmbledhje, trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe në parashtime, shqyrtoi provat shkresore të administruara në dosjen gjyqësore të kësaj çështjeje, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Rozeta Qirjaqi nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe në kontrollin e figurës. Për pasojë, nën dritën e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë e të pamjaftueshëm. Vendimi nr. 272, datë 08.07.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e saj nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 272, datë 08.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Rozeta Qirjaqi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 20.04.2023.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**KRYESUES**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*